




Ministria e Arsimit, Shkencës dhe
Teknologjisë e Republikës të Kosovës



FAKTET E PROJEKTIT

Titulli i plotë i projektit: Mbështetja dhe zhvillimi i strukturave për sigurimin e cilësisë në bartësit private të arsimit të lartë në Kosovë

Titulli i shkurtuar: Q&A at the PHEP in Kosova

Numri i Projektit: 159051-TEMPUS-AT-TEMPUS-SMGR

Kontraktuesi: Universiteti i Salzburgut, AT

Koordinator: WUS Austria, AT

Kohëzgjatja e Projektit: 15/01/2010 - 14/01/2012

Buxheti Total: € 526,498.00

Projekti është financuar nga Komisioni Evropian nëpërmjet Tempus IV - afati i dytë për propozime (EAC/01/2009)

Kontakt: Prof. Dr. Peter Eckl
peter.eckl@sbg.ac.at

University of Salzburg
Hellbrunnerstrasse 34
Salzburg, A-5020
Tel: +43 662 8044 5782
Fax: +43 662 8044 144

But Dedaj
but.dedaj@wus-austria.org

Mjellma Carabregu
mjellma.carabregu@wus-austria.org

Faculty of Philology, str. Nena Tereze, n.n.
10000 Prishtina, Kosova
Tel/fax: +381 38 241 472

Michaela Handke
michaela.handke@wus-austria.org

Lichtenfelsgasse 21,
A-8010 Graz, Austria
Tel: +43 316 38 22 58 22
Fax: +43 316 93 17 51

This project has been funded with support from the European Commission. This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.



“ Mbështetja dhe zhvillimi i strukturave për sigurimin e cilësisë në bartësit privat të arsimit të lartë në Kosovë ”

QA



PËRFITUESIT E PROJEKTIT:

- AAB - RIINVEST, Kosovë
- BIZNESI, Kosovë
- DARDANIA, Kosovë
- EVOLUCIONI, Kosovë
- FAMA, Kosovë
- ILIRIA, Kosovë
- PJETËR BUDI, Kosovë
- TEMPULLI, Kosovë
- UBT, Kosovë
- UNIVERSUM, Kosovë

Në mënyrë që Kosova të integrohet me sukses në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL) është me rëndësi jetike për vendin që të përfshijë standardet dhe parimet që janë të përcaktuara nga vendet e Bashkimit Evropian, duke përfshirë **standardet e larta të cilësisë në mësimdhënie dhe në kërkime shkencore**. Sigurimi i cilësisë, themelimi, zhvillimi dhe monitorimi i standardeve dhe i udhëzimeve, përfaqësojnë elemente kyç të arsimit të lartë. Kjo kontribuon në besueshmërinë dhe në vlerat shkencore e profesionale të bartësve të arsimit të lartë dhe siguron një cilësi të lartë të programeve të studimeve dhe të aktiviteteve kërkimore. Përfshirja e njësive të sigurimit të cilësisë në strukturën e bartësve të arsimit të lartë, ofron mbikëqyrjen më të mirë të aplikimit të këtyre standardeve dhe menaxhimit cilësor të këtyre institucioneve, si dhe të mësimdhënies e të punës kërkimore. Kjo, për më tepër, ofron një platformë për reforma që do të jenë të dobishme për bartësit e arsimit të lartë.

Qëllimi i projektit është themelimi apo përmirësimi i mekanizmave dhe i instrumenteve për sigurimin e cilësisë (aspektet dhe standardet e cilësisë) në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë, në përputhje me objektivat e **Strategjisë për zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë (2005-2015)** dhe **Parimet e Bolonjës** të Bashkimit Evropian. Për më tepër, përfshirja e komponentëve për sigurimin e cilësisë përbën një pjesë thelbësore të kërkesave të paraqitura nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës, si me rastin e akreditimit institucional, ashtu edhe të kurrikulave. Organizimi i sistemit për sigurim të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë karakterizohet nga:

- nevoja për krahasueshmëri të procedurave menaxhuese të bartësve privatë të arsimit të lartë dhe sistemeve/infrastrukturës së tyre për sigurimin e cilësisë.
- nevoja për një program për përmirësimin e praktikave të sigurimit të cilësisë në gjithë hapësirën e arsimit të lartë në Kosovë me/nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Projekti **“Mbështetja dhe zhvillimi i strukturave për sigurimin e cilësisë në bartësit privat të arsimit të lartë në Kosovë”** ka për qëllim të adresojë këto nevoja të veçanta, duke u përpjekur të instalojë mekanizma të suksesshëm në dhjetë bartës privatë të arsimit të lartë (BPAL), të përfshirë në projekt.

Qëllimi i projektit është ngritja dhe forcimi i njësive për sigurimin e cilësisë të këta bartës privatë të arsimit të lartë (BPAL) në Kosovë:

- AAB - RIINVEST
- BIZNESI
- DARDANIA
- EVOLUCIONI
- FAMA
- ILIRIA
- PJETËR BUDI
- TEMPULLI
- UBT
- UNIVERSUM

Rezultatet e projektit:

1. Vlerësimi i situatës lidhur me sigurimin e cilësisë në BPAL;
2. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit për rëndësinë e sigurimit të cilësisë për mësimdhënie, mësimnxënie dhe proceset e administrimit;
3. Ngritja e kapaciteteve;
4. Zhvillimi i sistemeve të sigurimit të cilësisë të bartësit privat të arsimit të lartë në Kosovë;
5. Shpërndarja e informacioneve dhe e rezultateve të projektit; dhe,
6. Qëndrueshmëria e projektit, monitorimi dhe kontrolli i cilësisë së zbatimit të tij.

Të gjitha BPAL të marrin mbështetje për ngritjen e njësive të reja, ose për përmirësimin e zyrave/qendrave/njësive ekzistuese për sigurim të cilësisë. Përvoja, ekspertiza dhe modelet e praktikave më të mira për sigurim të cilësisë nga partnerët e BE-së, do të jenë mjetet kryesore për t'i arritur objektivat e tërësishme të projektit. Instalimi i sistemeve të qëndrueshme për sigurimin e cilësisë në të gjithë BPAL, do të kontribuojë në rritjen e cilësisë në mësimdhënie, mësimnxënie dhe në proceset administrative të BPAL. Kjo do të realizohet nëpërmjet trajnimeve që do t'u ofrohen zyrtarëve për sigurimin e cilësisë në të gjitha BPAL.

1. VLERËSIMI I SITUATËS LIDHUR ME SIGURIMIN E CILËSISË NË BPAL

Do të bëhet shpërndarja e pyetësorëve në të gjitha BPAL, për një vlerësim të situatës aktuale në sigurimin e cilësisë. Në përputhje me rezultatet e anketës, në çdo BPAL do të zhvillohet një plan më i mirë i veprimit për instalimin e sistemeve për sigurim të cilësisë.

2. RRTJJA E NIVELIT TË NDËRGJEGJËSIMIT PËR RËNDËSINË E SIGURIMIT TË CILËSISË PËR MËSIMDHËNIE, MËSIMNXËNIE DHE PROCESET E ADMINISTRIMIT

Ditët e informacionit do të zhvillohen në të gjitha dhjetë BPAL për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e sigurimit të cilësisë për mësimdhënësit, studentët dhe për të gjitha nivelet e menaxhimit institucional.

3. NGRITJA E KAPACITETEVE

- Do të organizohen trajnime të ndryshme për:
- Menaxhmentin dhe stafin administrativ,
 - Mësimdhënësit, dhe
 - Studentët.

4. ZHVILLIMI I SISTEMEVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË TË BARTËSIT PRIVATË TË ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË

Njësitë për sigurim të cilësisë do të vendosen në BPAL përkatës, ose efikasiteti dhe kapaciteti i tyre do të përmirësohet. Vizitat në Kosovë dhe në vendet partnere të BE-së do të mundësojnë shkëmbimin efikas të përvojave dhe të praktikave më të mira për sigurim të cilësisë. Përmes punëtorive të ndryshme që do të organizohen, do të zhvillohen dokumente të nevojshme dhe relevante (manuali për sigurim të cilësisë, udhëzimet për kryerjen e raporteve të brendshme të vetëvlerësimit).

5. SHPËRNDARJA E INFORMACIONEVE DHE E REZULTATEVE TË PROJEKTTIT
Masat për shpërndarje të informatave do të përbëjnë një komponentë thelbësore të këtij projekti në të gjitha fazat e zbatimit të tij. Dispozitat për shpërndarjen e objektivave të projektit dhe të informatave të përgjithshme për sigurim të cilësisë, përfshijnë shpërndarjen e materialit promovues dhe informativ, krijimin e një ueb-faqeje, ngjarjet informative/promovuese dhe komunikimin konstant me pjesëmarrësit e projektit. Aktivitetet e shpërndarjes do të vazhdojnë edhe pas përfundimit të projektit, përmes njësive të themeluara të sigurimit të cilësisë dhe platformave virtuale (ueb-faqes) dhe kjo do të mbajë të informuar pjesëmarrësit, mësimdhënësit, studentët dhe publikun rreth zhvillimeve më të reja në fushën e sigurimit të cilësisë.

6. QËNDRUESHMËRIA E PROJEKTTIT, MONITORIMI DHE KONTROLLI I CILËSISË SË ZBATIMIT TË TIJ

Monitorimi dhe kontrolli i cilësisë do të sigurohen gjatë gjithë procesit të implementimit të projektit me anë të mjeteve dhe të procedurave të ndryshme, të cilat përfshijnë komunikimin e gjerë ndërmjet partnerëve të projektit, rivlerësimin e vazhdueshëm të status quos dhe reagimeve të bazuara në rezultatet e pyetësorëve (feedback-ut). Qëndrueshmëria është siguruar përmes një qasjeje individuale në zbatimin e objektivave të projektit, të cilat përputhen me nevojat individuale dhe me interesat specifike të çdo institucioni. Për më tepër, kjo do të thotë përdorim të një qasjeje nga poshtë-lart dhe nga lart-poshtë, që përfshin studentët, stafin akademik dhe joakademik, si dhe stafin menaxhues.